

Projektet e studentëve në Fakultetin e Shkencave Politike/fushën e digjitalizimit

Në kuadër të fakulteteve organizohen edhe punë hulumtuese e shkencore edhe nga ana e profesorëve dhe studentëve.

Universitetit “Kadri Zeka” dhe Komunës së Gjilanit kanë arritur bashkëpunim për digjitalizimin e shërbimeve të Stacionit të Autobusëve dhe shkollave të mesme në Gjilan. Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë prezantuar punën e tyre në përpilimin elektronik të orarit mësimor, ueb faqes së shkollave, digjitalizimin të punës dhe shërbimeve në stacionin e autobusëve si dhe aplikacionin për menaxhimin e pagesave dhe shërbimeve hoteliere me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për publikun me këtë rast shkollat dhe ndërmarrjet, e në të ardhmen edhe institucionet tjera publike dhe rrjetin e bizneseve në përgjithësi.

Vetëm në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në lëndën e Projektit hulumtues, e cila është lëndë mësimore obligative në semestrin e tretë janë bërë këto projekte:

- Komunikimet ndërmjet kompjuterit, pllakës elektronike Arduino Uno, Serial Monitor dhe VT 100, me programim në C++
- Ndërtimi i sistemit për kyçjen e çkyçjen e LED diodave të displeit 7 segmentësh duke programuar mikrokontrollerin ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit në prezentimin e shkronjave A, B, C, E dhe F në kohë të caktuar në displein 7 segmentësh në kohë të caktuar dhe programimi i mikrokontrollerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit digjital përmes të cilit kryhet prezentimi numerik nga 99 gjer në 0 duke përcjellur punën e semaforit në udhëkryq dhe programimi i mikrokontrollerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit përmes të cilit 6 LED dioda me ngjyra të ndryshme ndriçojnë në kohë të caktuar dhe për një kohë tjetër nuk ndriçojnë, duke programuar mikrokontrollerin në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për prenotime të hapësirave hotelierike
- Ndërtimi i sistemit digjital përmes të cilit lexohen kodet e RFID kartelave përmes USB Reader dhe evidenton hyrjet e daljet e studentëve në salla mësimi në Universiteti Kadri Zeka, duke programuar në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për: reklamimin Shitjen dhe distribuimin e barnave popullore të një farmacie popullore
- Ndërtimi i aplikacionit për caktimin e numrit të ulëseve të fituara në Asamblenë Komonale në zgjedhjet lokale në Luginë të Preshevës sipas sistemit të Dontit!
- Ndërtimi i sistemit digjital kopshti i “mençur” përmes pllakës elektronike Arduino Uno me mikrokontroller ATMEGA 328P dhe programimi i tij në gjuhën programuese C++
- Zhvillimi evolutiv i PC në raport me zhvillimet në Sisteme të shpërndara kompjuterike
- Disa protokolle më të rëndësishëm në shtresën e aplikacionit dhe simulimi i tyre përmes Packet Tracer
- Baza të dhënash dhe Siste të shpërndara, Data Lake
- Krijim i disa qareve dixhitale të kombinuara përmes elementeve logjike AND (7409), OR(7432) dhe NOT
- Aplikimi i Google suite për punë ekipore në dokument tekstual, tabelar, prezantues dhe ueb
- Mikrokontrolleri Arduinouno, përshkrim hardverik, softveri dhe programimi me C++ i disa projekteve praktike

- Roli i ruterit në WAN, zhvillimi evolutiv i tyre, konfigurimi dhe një simulim përmes Packet Tracer
- Uebaplikacioni "Vullnetarët e Shkencave Kompjuterike"
- Uebaplikacioni "Gjeje një zhvillues për projekt"
- Uebaplikacioni "Biçikleta për huazim"
- Uebaplikacioni "Turizmi në Kosovë"
- Ndikimi i Vizualizimit dhe Procesimit të Imazheve në Mjekësi.
- Roli i Memories në Grafiken e Kompjuterëve